



Nr. 6931/14 Prot., Datë 02/09/2024



Nr. 3404/14 Prot., Datë 30/08/2024

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
MIDIS
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DHE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E RUAJTJES DHE
RESTAURIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet sot, në Tiranë, më datë 30/08/2024, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me adresë: Rruga e Durrësit nr.23, Tiranë, përfaqësuar nga zëvendësministri, Znj. Ana Kapaj,

Dhe

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me adresë: Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr.3, Tiranë përfaqësuar nga zëvendësministri, Znj. Lira Pipa,

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, më poshtë referuar si “Palët”, duke pranuar se:

- Trashëgimia Kulturore Shqiptare është identifikuar si çështje e rëndësishme në Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit I/IPA I (2007-2013), me anë të të cilit ka përfituar mbështetje nga programi kombëtar IPA në vitin 2009 me fishën “Mbështetje për Zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të trashëgimisë kulturore dhe historike- Faza II”;

- Gjithashtu, sipas IPA II (2014 - 2020), trashëgimia kulturore është përcaktuar si shtytë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe progresit ekonomik të Shqipërisë duke u parashikuar përkatësisht në Programin vjetor të veprimit të IPA për Shqipërinë për vitin 2017, me anë të të cilit është siguruar gjithashtu edhe pjesëmarrja në programet përkatëse të Bashkimit Evropian që kanë ndikim në fushën e kulturës. Në vijim, në IPA II trashëgimia kulturore është trajtuar edhe në Programin vjetor të veprimit të IPA për Shqipërinë për vitin 2018, në Sektorin e Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit, ku aksioni 5 i tij ka parashikuar mbështetjen financiare të IPA për vitin 2018 për formulimin e një qasje të re që lidh objektet turistike, të transportit, shërbimet mjedisore, dhe ekonominë me menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- Gjithashtu, në Vendimin e Komisionit Evropian të datës 16.7.2020 “ Për miratimin masës së dytë të veçantë në favor të Shqipërisë për rindërtim dhe rehabilitim pas tërmeteve për vitin 2020”, arsimi dhe trashëgimia kulturore u identifikuan si sektorë prioritarë për të përfutur mbështetje financiare nga Komisioni Evropian;
- Trashëgimia kulturore përfaqëson një mjet të fuqishëm për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit në procesin e vendimmarrjes dhe zhvillimit ekonomik;
- Artet dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri, konsiderohen si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit sipas vizionit të shprehur përkatësisht në shtyllën e tretë (Kohezioni Social), në kapitullin “Fuqizimi i artit, kulturës dhe sporteve” të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030,. Gjithashtu në këtë kuadër, trashëgimia kulturore përbën një ndër shtyllat në të cilat mbështetet zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, i përcaktuar gjithashtu si përparësi strategjike për rritjen ekonomike të vendit në këtë dokument strategjik;
- Trashëgimia Kulturore ka potencialin për të ndikuar në rritjen e angazhimit publik dhe promovimit të identitetit kulturor kombëtar, duke i lejuar qytetarët të luajnë një rol më aktiv në shoqëri përmes ndjenjës së përkatësisë ndaj komunitetit dhe mirëkuptimit ndërkulturor;

bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi me përmbajtje si vijon:

Neni 1

Ky Memorandum Mirëkuptimi është një marrëveshje e ndërsjellë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të nxitur

dhe rritur bashkëpunimin në fushën e gjurmimit, hulumtimit, studimit, projektimit, konservimit dhe restaurimin të trashëgimisë kulturore, në mënyrë që të ofrohen bazat e nevojshme për krijimin e një sistemi arsimimi, kërkimi si dhe trajnimi efikas dhe të optimizuar për ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore shqiptare sipas nevojave kombëtare në këtë fushë, të harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore.

Neni 2

Memorandumi i Mirëkuptimit ka për qëllim:

- a) Rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë për kërkimin e aplikuar për ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore.
- b) Rritjen e mbështetjes për ndërkombëtarizimin e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë dhe institucioneve të specializuara në trashëgimi kulturore.
- c) Zhvillimin dhe promovimin e arsimit dhe trajnimit të nivelit të lartë, kërkimit shkencor dhe praktikës në fushën e konservimit-restaurimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, në përputhje me nevojat kombëtare.
- d) Vendosjen e bashkëpunimit që ndihmon në përcaktimin e standardeve dhe kriterëve profesionale të nevojshme për profesionin e restaurues në Shqipëri, në përputhje me kërkesat për këto profesione në Bashkimin Evropian.
- e) Të mbështesë përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me profesionin e restauruesit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë.
- f) Rritjen e bashkëpunimit për promovimin e profesionit të restauruesit në Shqipëri.

Neni 3

Për realizimin e synimeve të Memorandunit të Mirëkuptimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit:

- a) Do të mbështesin, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, zhvillimin e nismave dhe projekteve kërkimore në lidhje me trashëgiminë kulturore.
- b) Do të inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin ndërmjet subjekteve arsimore që ofrojnë edukim dhe trajnim në fushën e trashëgimisë kulturore në Shqipëri.
- c) Mbështesin përfshirjen në aktivitete mobiliteti të stafit mësimdhënës, kërkimor dhe teknik, si dhe studentëve në institucionet e arsimit të lartë, brenda kuadrit ligjor në fuqi.

d) Do të bashkëpunojnë drejt një qasje të përbashkët dhe të qëndrueshme për mundësitë e punësimit dhe kërkesën e tregut të punës në territorin shqiptar për profesionin e restauruesit të trashëgimisë kulturore, në përputhje me standardet e BE-së për këtë profesion.

e) Do të angazhohen të analizojnë dhe rishikojnë, nëse dhe kur është e nevojshme, kuadrin ligjor për profesionin e restauruesit duke e harmonizuar atë me legjislacioni përkatës të Bashkimit Evropian në këtë fushë.

f) Angazhohen të rrisin bashkëpunimin ndërmjet tyre për nisma që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për kërkimin e aplikuar në fushën e trashëgimisë kulturore në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.

g) Angazhohen të mbështesin, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, ndërkombëtarizimin e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë dhe institucioneve të specializuara në trashëgimi kulturore në lidhje me kërkimin në fushën e ruajtjes dhe restaurimit së trashëgimisë kulturore, si dhe t'i inkurajojnë ato të bashkëpunojnë me organizata evropiane dhe ndërkombëtare për të siguruar përfaqësimin e profesionit të restauruesit në këto organizata dhe mbrojtjen e interesave morale, kulturore, shkencore dhe materiale të këtij profesioni.

h) Do të rrisin bashkëpunimin për të zhvilluar dhe promovuar një nivel të lartë arsimimi dhe trajnimi, kërkimi dhe praktike në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, në përputhje me politikat dhe nevojat kombëtare.

i) Do të punojnë për përcaktimin e standardeve dhe kritereve profesionale të nevojshme për ushtrimin e profesionit të restauruesit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, në përputhje me kërkesat për këto profesione në Bashkimin Evropian.

j) Do të bashkëpunojnë për ndërmarrjen e nismave të përbashkëta që ndihmojnë në promovimin e profesionit të restauruesit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

Neni 4

Ministria e Arsimit dhe Sportit angazhohet:

1. të bashkëpunojë me institucionet e arsimit të lartë dhe organizata të tjera trajnuese që veprojnë në fushën e ruajtjes dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore si dhe mbledh prej tyre rekomandime në lidhje me nismat kombëtare në këtë fushë,
2. të inkurajojë dhe mbështesë mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve përmes programeve të Bashkimit Evropian apo programeve të tjera ndërkombëtare që mbështesin mobilitetin,
3. në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas nevojës së shprehur nga ky institucion, të kontribuojë në përcaktimin e

aftësive dhe njohurive të restauruesit në krahasim me profesionet e tjera që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore, duke përcaktuar kështu nivelin e edukimit dhe kërkimit të nevojshëm në fushën e ruajtjes dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore për secilin prej tyre,

4. të ndajë dhe diskutojë dokumentet dhe propozimet me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,
5. të emërojë një person kontakti për qëllim të këtij Memorandumi.

Neni 5

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit angazhohet:

- a) të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit, institucionet e arsimit të lartë dhe organizatat e tjera që veprojnë në këtë fushë për çështje që lidhen me ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.
- c) të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në lidhje me aspekte të praktikës profesionale të studentëve në objektet e trashëgimisë kulturore në kuadër të programeve të studimit.
- d) të emërojë një person kontakti për qëllim të këtij Memorandumi.

Neni 6

Aktivitetet që rrjedhin nga zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk sjellin detyrime financiare për palët.

Neni 7

Në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me çështjet e përfshira në këtë memorandum, ato do të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet palëve.

Neni 8

Memorandumi i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga zyrtarët e autorizuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të pezullohet ose ndërpritet në çdo kohë nga njëra palë, duke informuar palën tjetër me shkrim. Pala, e cila dëshiron të pezullojë apo ndërpresë memorandumin, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbi qëllimin e saj për pezullimin ose ndërprejen.

Nënshkruar në Tiranë në datën 30 të 08.2024 në dy kopje në gjuhën shqipe, të dyja janë njësoj të vlefshme.

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Ekonomisë, Kulturës
dhe Inovacionit

ZËVENDËSMINISTËR

ZËVENDËSMINISTËR

Ana Kapaj

Lira Pipa

